

K Ë R K E S Ë

PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR TË DHIMITËR ÇUKOS

GJYKATËS SË RRETHIT TË FIERIT

Kërkuese: Marjeta Nikollaq Çuko, datëlindja 1962, lindur e banuese në Fier, lagjja "Kongresi i Përmetit", rruga "Ismet Dertliu"

Objekti: Kërkoj shpalljen si të zhdukur të bashkëshortit tim Dhimitër Çuko në bazë të nenit 15 e vijues të Kodit Civil dhe të nenit 375 dhe vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëshorti im më datën 13 nëntor 1991, së bashku me gjashtë persona të tjerë, janë nisur nga brigjet e Hoxharës për në drejtim të Italisë dhe që nga ajo kohë dhe deri më sot nuk kam marrë asnjë njoftim prej tij dhe që nga ajo kohë ai mungon edhe nga vendi i banimit tonë.

Gjithashtu, edhe personat e tjerë që kanë ikur me të nuk kanë asnjë lidhje me të afërmit e tyre. Në këto kushte, kur bashkëshorti im nuk ka komunikuar me mua apo me të afërm të tjerë, konform ligjit kërkoj që ai të shpallet nga gjykata si i zhdukur.

KËRKUESE
Marjeta Çuko